



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Korrik, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi, drejtor i DSH-së
Përgatitur	Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi në DSH

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit Korrik 2020 Drejtoria e Shëndetësisë ka pranuar lëndë të ndryshme për tu shqyrtuar nga komisioni profesional. Stafi në këtë drejtori, ka pasur takime të përditshme me qytetarë për tu njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Renovime dhe përmirësimeve të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Monitorim dhe mbështetje të aktiviteteve bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja si dhe në QMU;
- Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së;

- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planit të prokurimi 2020;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Identifikimi i nevojave rreth përpilimit të specifikave:
 - Furnizim me inventar për nevojat e objekteve shëndetësore – KPSH;
 - Furnizim me pajisje mjekësore – KPSH;
 - Furnizim emergjent me reagensë serologjik për testim të # Covid 19;
 - Furnizim me pajisje mbrojtëse për punëtorët shëndetësorë në luftën kundër # Covid 19 – pakoja emergjente;
- Monitorim i aktiviteve:
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objektit QMU;
 - Furnizim me barna dhe material shëndetësor mjekësor;
 - Furnizim me material shpenzues stomatologjik;
- Përfundim i specifikave për aktivitetin:
 - Furnizim emergjent me reagensë serologjik për testim të # Covid 19;
 - Furnizim me pajisje mbrojtëse për punëtorët shëndetësorë në luftën kundër # Covid 19 – pakoja emergjente;
 - Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e KPSH-së;
- Publikim për ofertim:
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekësor LOT 3 – ritender;
 - Renovime dhe përmirësim të infrastrukturës së Institucioneve të KPSH-së;
 - Furnizim emergjent me reagensë serologjik për testim të # Covid 19;
 - Furnizim me pajisje mbrojtëse për punëtorët shëndetësorë në luftën kundër # Covid 19 – pakoja emergjente;
- Përcaktim i stafit menaxhues për aktivitetin:
 - Furnizim emergjent me reagensë serologjik për testim të # Covid 19;
 - Furnizim me pajisje mbrojtëse për punëtorët shëndetësor në luftën kundër # Covid 19 – pakoja emergjente;
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe mjekësor;
- Përcaktim i stafit vlerësues për aktivitetin:
 - Sigurimi i automjeteve të Komunës, QKMF-së, QMU-së dhe BPZ;
 - Pastrimi i objekteve shëndetësore KPSH në Komunën e Prishtinës;
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik, LOT 3 – ritender;
- Anulohet aktiviteti në ofertim – Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve KPSH në komunën e Prishtinës;
- Sqarime profesionale në vazhdimësi rreth kërkesave nga ofertuesit në procedurë prokurimi;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;

- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Në prioritet ndërmarrjen e masave preventivë rreth parandalimit të corona-virusit;
- Njoftim i vazhdueshëm rreth riorganizimit të personelit shëndetësor mbi gatishmërinë e përhapjes së Corona-virusit;
- Gjatë muajit korrik, ishin 2183 raste pozitive me # Covid 19;
- Plotësim të dhënash - Plani kombëtarë për zbatimin e MSA -së, për periudhën janar - qershor 2020;
- Plotësim të dhënash - Raporti dhe strategjia sektoriale si bazë për hartimin e Planit zhvillimor komunal dhe Hartës zonale komunale të Prishtinës.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Identifikimi i nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore edhe gjatë gjendjes emergjente, si pasojë e pandemisë globale;
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësor edhe gjatë gjendjes emergjente, si pasojë e pandemisë globale;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve - shëndetësore.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Fondi Burimor	Planifikuara	Alokuara	Shpenzuara	Nr. Lëndëve
Pagat	7,140,000	522,366.60		
Mallra dhe shërbime	1,360,000			
10	622,047.00	505,000.00	18,670.20	24
21	387,953.00		18,466.08	1
Komunali	310,000.00	155,000.00	14,195.10	79
Subvencione	1,200,000.00	50,000.00		
Kapitale	1,190,000.00			

21		425,000.00	42,580.00	2
22		599,738.46		
Gjithsej		2,257,105.06	93,911.38	106

- Raport - deklarim të borxheve më të vjetra se 30 ditë;
- Deklarimi për ATK-në;
- Raport mujor për shpenzimet e realizuara dhe të hyrat nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore;
- Raport për bartje të mjeteve për Drejtorinë e Financave;
- Raportimi i detyrimeve për përgatitjen e pasqyrave financiare;
- Pranim të faturave dhe arkivimi i tyre;
- Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për procedim të mëtutjeshëm;
- Zotimi;
- Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në prokurim dhe Financave dhe
- Përgatitja e deklaratave të disponueshmërisë për procedura të prokurimit.

5.1.2. Takimet me palë

5.1.3. Takimet me institucione të tjera

- Drejtoria e Investimeve Kapitale;
- Drejtoria e Prokurimit;
- Drejtoria e Arsimit;
- Drejtoria e Parqeve;
- Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm - Sektori për planifikim.

5.1.4. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

Raportime të përditshme me media lokale: RTV 21, RTV Dukagjini, TV Klan dhe RTK.

5.1.5. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Kemi pasur gjithsej 38 lëndë të pranuar.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve:

Komisioni për subvencione u përcaktua për 154 përfitues.

5.1.8. Takime të tjera

- MSH,
- IKSHIP.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të DSH-së tani e sa vjet;
- Mungesa e stafit shëndetësor në objektet e KPSH-së;
- Trajnime të ndryshme të personelit - DSH, përgjegjësitë e përditshme zyrtare;
- Numri i jo mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve, bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

Gjatë muajit korrik 2020, ka vazhduar organizimi i brendshëm, i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) ka vazhduar puna pa ndërprerje (24/7). Në katër qendra të tjera (QMF 2, QMF 6, QMF Besi dhe QMF Hajvali) është zbatuar orari i punës prej: 07:00 – 19:00 në ndërresa 12-orëshe me tri ekipe (një ditë punë 12 orësh – dy ditë pushim). Ky organizim i punës është bërë për të përballuar nevojat dhe kërkesat për zbatimin e masave, rekomandimeve dhe obligimeve tonë kundruall parandalimit dhe frenimit të pandemisë COVID -19, përkundër

mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit. Në qendrat tjera është punuar në një ndërrim nga ora 08:00 – 16:00.

Duke filluar nga java e fundit e qershorit 2020, kemi regjistruar rastet e para të infeksionit me COVID -19 në mesin e stafit mjekësor dhe deri më 31 korrik 2020, kemi pasur plot 140 punonjës të QKMF-së që për periudha të caktuara kohore kanë qenë të izoluar dhe jashtë vendit të punës. Prej këtyre 49 veta kanë qenë me COVID - 19 të konfirmuar në mënyrë laboratorike (RT-PCR testi).

Në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, në hyrje kanë vazhduar të qëndrojnë ekipet e përbëra nga (mjeku familjar dhe infermiera) për triazhimin e pacientëve. Gjatë kësaj periudhe kohore është kërkuar nga personeli shëndetësor ndërprerja e shfrytëzimit të pushimeve vjetore dhe rritja e kujdesit dhe kritereve për shfrytëzimin e pushimeve mjekësore.

Vazhdimisht janë bërë vizita monitoruese, duke vizituar të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërresa e paraditës, pasditës dhe e natës) dhe janë konstatuar të gjeturat vijuese:

- ✓ Të gjithë ishin në vendet e tyre të punës;
- ✓ Respektohen rregullat e përgjithshme;
- ✓ Furnizimi me pajisje dhe masa mbrojtëse ishte i mirë;
- ✓ Masat parandaluese në nivelin e duhur;
- ✓ Të gjithë të pajisur me masa mbrojtëse (maska, dorëza, dezinfektues);
- ✓ Në të gjitha Qendrat vërehej një numër stabil i pacientëve;
- ✓ Pastërtia qëndron në nivel të lartë.

Poliklinika e Stomatologjisë dhe Shërbimi stomatologjik ka vazhduar punën në QMF II, QMF IV, QMF V, Poliklinika e Stomatologjisë. Orari i punës: 07:00 – 19:00, puna është e organizuar në tri ekipe; një ditë punë 12 orësh, dy ditë pushim.

Shërbimi i vaksinimit – Që nga 1 qershori 2020, ka vazhduar punën me orar të rregullt dhe ka vazhduar vaksinimi i fëmijëve të porsalindur me BCG, Hepatit dhe vaksinimi i personave të lënduar me Te Al dhe Tetabulinë. Gjatë muajit korrik 2020, janë administruar 3490 vaksina.

Shërbimi laboratorik – ka filluar me realizimin e testeve serologjike nga 20 korriku 2020, në AMF në Qendrën e studentëve. Gjatë muajit korrik janë kryer mbi 1400 teste serologjike.

Përndryshe, gjatë muajit korrik 2020 janë realizuar gjithsej:

- ✓ 41536 vizita mjekësore;
- ✓ 52281 shërbime shëndetësore;
- ✓ 22030 shërbime laboratorike (pa QKMF, QMF 3 dhe QMF 11);
- ✓ 2589 shërbime stomatologjike;
- ✓ 1522 shërbime radiologjike.

Të tjera:

Deri më 31 korrik 2020, në QKMF me njësitë e saj, ishin 140 punonjës shëndetësorë të izoluar, prej të cilëve 49 të konfirmuar si pozitiv në COVID – 19.

REKOMANDIME

1. Shpalljen e konkursit për pranimit të punonjësve të rinj, për shkak të pozitive të mbetura bosh nga pensionimi i stafit (rreth 40 pozita);
2. Planifikimin e nevojave për PPM dhe pajisjes të tjera medicinale për përballimin e valës së dytë të pandemisë me COVID - 19 në vjeshtë.

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit qershor 2020, ka vazhduar të ofrojë shërbime urgjente për të gjithë banorët e Prishtinës dhe fshatrave që i takojnë kësaj komune, përmes Shërbimit të Urgjencës Mjekësore në terren me 4 ekupe mjekësore përmes autoambulancave.

QMU gjatë muajit korrik 2020, kishte 10 punonjës të prekur me # Covid 19, të cilët edhe u vetizoluan sipas rekomandimeve të IKPSH-së.

Aktivitetet gjatë këtij muaji ishin:

- Më 27.07 dhe 28.07.2020, me kërkesën e Federatës së Autosporteve të Kosovës, për sezonin 2020, të kampionatit të Kosovës, është asistuar me nga një ekip mjekësor.
- Më 29.07.2020, me kërkesë të FFK-së, është asistuar me një ekip mjekësor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente u trajtuan sipas prioriteteve të triazhës, ku dominuan rastet me:

- Kriza hipertenzive;
- Bronchit acut;
- Colikat abdominale;
- Gastroenterocolite acute;
- Reakcionet alergjike;
- Gjendjet anksiozo-depresive;
- Gjendjet febrile;
- Aksidentet e trafikut etj.

QMU gjatë periudhës raportuese mesatarisht kishte rreth 2000 thirrje në linjën emergjente - 194, nga ana e qytetarëve. Një numër i madh i qytetarëve mori këshilla se si të veprohet kur kishte dyshime me infeksion me # COVID 19. Këshilla u dhanë nga dispeçeri dhe mjeku përgjegjës i ndërrimit.

Duke marrë parasysh se është përcjellë rreziku i përhapjes së COVID -19 në Kosovë, por edhe në regjion (shtetet për rreth), stafi mjekësorë vazhdon të respektojë masat mbrojtëse të vigjilencës dhe sigurisë në punë.

Nga Ministria e Shëndetësisë në formën elektronike është pranuar "Manual për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid -19".

Nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, u morën udhëzime rreth preventivës nga # Covid 19. Ndërkaq 2 fletushka (banerë) të përgatitura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, u vendosën në vende të dukshme për t'u njoftuar stafi dhe qytetarët.

Njëra fletushkë ishte Udhëzues për ruajtjen e shëndetit gjatë udhëtimit, ndërsa tjetra ishte mbi masat e sigurisë ushqimore. Personeli shëndetësor ishte i informuar me kohë në mënyrë shkencore, lidhur me pandeminë #Covid 19. Materialet ishin siguruar nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, si dhe Zyra e Organizatës Botërore e Shëndetësisë – Prishtinë.

QMU me ekipet e veta, që nga fillimi i pandemisë trajtoi edhe raste me # Covid 19, përderisa rasteve të rënda u është ofruar transport në Klinikën Infektive të QKUK-së. Gjithashtu, pacientëve të shëruar ose pacientët me deklarata për vetizolim, me kërkesë të mjekëve, nga Klinika u transportuan deri në shtëpi. Pas çdo transporti të pacientëve të dyshimtë me # COVID 19, autoambulancat u dezinfektuan. Ekipet mjekësore ishin të kujdesshme, duke përdorur me përpikëri masat mbrojtëse, dhe si rezultat nuk kishte asnjë punëtor të infektuar me # COVID 19. Përkundër kapaciteteve dhe stafit të limituar, edhe gjatë kësaj periudhe pacientët u informuan dhe u trajtuan me kohë dhe shërbime shëndetësore profesionale.

Bazuar në situatën epidemiologjike nga të dhënat e MSH dhe IKSHP, për shkak të rritjes së numrit të rasteve infektive me # COVID 19, personeli shëndetësor vazhdoi përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, mbajtjes së distancës, higjienës personale dhe ambientit të punës. Gjatë kësaj kohe QMU kishte mbështetjen dhe bashkëpunimin profesional, përveç nga Drejtoria e Shëndetësisë, edhe nga Ministria e Shëndetësisë, IKSHP dhe Klinika Infektive. QMU falënderon Policinë e Kosovës për gatishmërinë e bashkëpunimit edhe në këtë kohë pandemie.

Rekomandim:

- Rritja e numrit të stafit profesional mjekësor.

Në kuadër të Edukimit të vazhdueshëm profesional, u realizuan ligjërata përmes platformës elektronike online ZOOM - Menaxhimi i Emergjencave Respiratore – Dr. Islam Husaj, spec.IMF-QTMF-Pejë.

Shërbimet dhe vizitat shëndetësore në QMU – korrik 2020.

1	Viz. Mj. Urgj. në terren	1380
	Viz. mj. të tjera	149
2	Vizita mjekësore në QMU	0
3	Shërbimi i kirurgjisë së vogël	0
4	Shërbimi i rea. në terren	3
	Shërbimi i rea. ne QMU	0
5	Observim (intenziv)	0
6	Shërbimi i infermierisë	0
7	Aksidentet	92
8	Fatkeqësitë në punë	4
	Fatkeqësi të tjera	42
9	Shërbimi laboratorik	0
10	EKG	19

11	Transportet	253
12	Konstatim vdekjeje	67
GJITHSEJ		2009